



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2016
Nr. Dok. 201601314/10

Lënda : Rekomandojmë marrjen e masave për caktimin e gjykimit të çështjes penale me Nr.00380 akti datë 26.02.2016, me të pandehur H. A. etj, për shkak të shfuqizimit të neneve 55/2 të Kodit Penal dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Penal, me vendimin Nr.9 datë 26.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

Drejtuar : Z.Rudin BAQLI
Kancelar i Gjykatës së Lartë

TIRANË

I nderuar zoti Baqli,

Në ankesën e tij datë 03.06.2016, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi H. A. i dënua me 6 vjet e 8 muaj burgim në bazë të nenit 278/5 të Kodit Penal dhe që vuan dënimin me burgim në I.E.V.P. Drenovë, Korçë ankohet ndaj Gjykatës së Lartë Tiranë, për zvarritje të padrejta gjykimi dhe kërkon ndihmën dhe ndërhyrjen e institucionit tonë për caktimin e gjykimit të rastit tij me Nr.00380 akti, datë 26.02.2016 në Gjykatën e Lartë Tiranë.

Nga verifikimet e kryera nga ana e jonë rezulton se:

Me vendimin penal Nr.24 datë 13.01.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Korçë, ankuesi H. A. është deklaruar fajtor për krimin e prodhimit dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit të parashikuar nga neni 278/5 i K.Penal dhe sipas kësaj dispozite dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale për gjykimin e shkurtuar të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit duke u dënua ky i pandehur me 6 vjet e 8 muaj burgim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin me Nr.400 datë 11.12.2015 të Gjykatës Apelit Korçë.

Ndaj këtyre vendimeve gjyqësore i pandehuri H. A. ka paraqitur rekurs duke kërkuar prishjen e këtyre vendimeve gjyqësore dhe ulje të masës së dënimit të dhënë.

Me vendimin me Nr.9 datë 26.02.2016 Gjykata Kushtetuese e RSH mbi kërkesën e Gjykatës së Apelit Vlorë, ka vendosur :

Pranimin e kërkesës.

Shfuqizimin e paragrafit të dytë të nenit 55 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013 si dhe të paragrafit të pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin me nr.98/2014.

Shfuqizimi i këtyre dispozitave ligjore nga Gjykata Kushtetuese ka krijuar boshllëk ligjor dhe shqetësim tek të dënuarit në bazë të dispozitave ligjore të shfuqizuara të cilat me të drejtë janë konsideruar si antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese. Ndërkohë ne vlerësojmë se nuk është e drejtë që të dënuarit në bazë të dispozitave ligjore, të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese ta vuajnë dënimin me burgime më të rënda se dispozita ligjore që ato kanë shkelur në realitet.

Në bazë të nenit 76 pika 2, germa “a” të Ligjit me Nr.8577 datë 10.02.2000”Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese në R.SH sipas të cilit, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese ndaj një vepre penale edhe gjatë kohës që është në diskutim nëse ai lidhet drejtëpërdrejtë me zbatimin e ligjit ose të aktit normative të shfuqizuar.

E ndodhur çështja në këto rrethana gjykohet se të dënuarit e kësaj kategorie u shkelet e drejta ligjore e garantuar nga Kushtetuta dhe aktet e tjera normative në fuqi.

Duke qënëse ato janë autor të veprave penale të armbëmbajtjes pa leje dhe janë dënuar me dispozita ligjore të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese kërkojmë që nga ana juaj të bazë të gjitha hapësirave ligjore dhe kerkesat e neneve 42/2 të Kushtetutës së RSH, dhe të nenit 6 i KEDNJ të caktohet menjëherë gjykimi i kësaj çështje penale.

Në nenin 29/3 të Kushtetutës së RSH thuhet se:”Ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese”.

Në nenin 63/3 të Kushtetutës thuhet se: ”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, nga administrata publike”, dhe në nenin 21/c të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paarqet rekomandim për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”.

Për sa më sipër, ju

REKOMANDOJMË :

1.Shpejtimin dhe caktimin e gjykimit të rastit penal me Nr.00380 akti, datë 26.06.2016, me të pandehur H. A. etj, për shkak të shfuqizimit të neneve 55/2 të Kodit Penal, shtuar me ligjin nr.144/2013 si dhe paragrafin e pestë dhe të gjashtë të nenit 278 të Kodit Pneal, shtuar me ligjin nr.144/2013, ndryshuar me ligjin nr.98/2014, shfuqizuar me vendimin Nr.9 dt.26.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

2.Mbi masat e marra për pranimin e këtij rekomandimi, nga ana juaj lutemi të njoftohemi me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI